

PLAN I PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2012

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 40, al.1, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25, al.1, pika d dhe nenit 27 al. 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, miratoi këtë

PLAN TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2012

Neni 1

Miratohet Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2012, si në vijim:

1. Mjetet e shpenzuara rreth pagesave në emër të udhëtimeve zyrtare për vitin 2011

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politik dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

2. Raporti i Drejtorisë e Inspektoratit

HARTUES: Drejtoria e Inspektoratit

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

3. Rregullorja për organizimin brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës

HARTUES: Shërbimi i personelit

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

4. Rishqyrtimi i Rregullores mbi shërbimet komunale-me theks të veçantë për ndalimin e ekspozimit të mallrave nëpër trotuare

HARTUES: Drejtoria e Inspektoratit

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

5. Rregullorja për caktimin e Zonave erozive në territorin e KK të Prizrenit

HARTUES: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

6. Miratimi i Planit Zhvillimor

HARTUES: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

KONSULTOHET: Këshilli i Ekspertëve për Planifikim Hapësinor

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

6. Raporti rreth implementimit të planeve rregullative (të miratuara nga Kuvendi)

HARTUES: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

KONSULTOHET: Këshilli i Ekspertëve për Planifikim Hapësinor

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

7. Informata rreth prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm, si dhe mirëmbajtja e ujësjellësit

HARTUES: Drejtoria për Shërbime Publike

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

8. Raporti final i buxhetit të Komunës për vitin 2011

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

9. Raporti tremujor i kryetarit të Komunës rreth realizimit të Buxhetit për vitin 2012

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

10. Informatë rreth grumbullimit të mbeturinave

HARTUES: Drejtoria për Shërbime Publike

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

11. Organizimi i transportit rrugor

HARTUES: Drejtoria për Shërbime Publike

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

12. Informatë rreth ndërtimit dhe rindërtimit të objekteve që janë pronë e Komunës

HARTUES: Drejtoria e Inspektoratit

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

13. Rregullore për punën e inspektoratit

HARTUES: Drejtoria e Inspektoratit

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

14. Bashkëpunimi i Komunës me fshatrat dhe vendbanimet urbane

HARTUES: Drejtoria e Administratës

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

15. Vendimi i autorizimit për huamarrje

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

16. Raporti rreth organizimit të punës në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës

HARTUES: Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

17. Rregullorja për ndarjen e bursave nga mjetet e Buxhetit të Komunës

HARTUES: Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

18. Dëgjimi publik i KAB-it për vitet 2013-2015

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit.

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

KONSULTOHEN: Qytetarët

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

19 . Raporti gjashtëmuor i Kryetarit të Komunës rreth realizimit të buxhetit për vitin 2012

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

20. Miratimi i Propozimvendimit për ndarjen e bursave

HARTUES: Drejtorja për Arsim dhe Shkencë

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

21. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2013

HARTUES: Drejtorja për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

22. Parkingjet e qytetit

HARTUES: Drejtorja e Shërbimeve Publike

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

23. Raporti i Kryetarit të Komunës rreth realizimit të Buxhetit për vitin 2012

HARTUES: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

24. Raporti i Auditorit

HARTUES: Auditori

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

25. Kushtet për përdorimin e objekteve nga personat me nevoja të veçanta

HARTUES: Drejtoria për mirëqenie sociale

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

26. Raporti financiar i ndërmarrjeve publike

HARTUES:

APROVUES DHE PROPOZUES: Kryetari i Komunës

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

27. Raportet e punës të komisioneve të themeluara nga Kuvendi

HARTUES DHE PROPOZUES: kryetarët e Komisioneve

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI: 2012

28. Miratimi i Planit të punës të Kuvendit për vitin 2013

PROPOZUES: Anëtarët e Kuvendit dhe drejtoritë komunale

SHQYRTON: Komiteti për Politikë dhe Financa

MIRATON: Kuvendi i Komunës

AFATI:2012

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive komunale dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në Web faqen zyrtare të Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-2584

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit

Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 6 , 7 , 9 , Ligjit mbi qasjen në dokumente publike ,nenit 12, al. 2, pika c, nenit 68 al. 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 2008/03 për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë në komuna të ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nenit 27, al 1 dhe 5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012 , miratoi këtë :

RREGULLORE PËR TRANSPARENÇË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- Forcimi i transparencës në punën e organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punën e ndërmarrjeve publike lokale që janë nën mbikëqyrjen apo qeverisjen e komunës

dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve (publikut), si dhe të organizatave të tjera nga shoqëria civile në vendimmarrje në nivel lokal;

- Krijimi i rregullave që mundësojnë realizimin-ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte dhe

- Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare komunale.

Fushëveprimi

Neni 2

Me këtë Rregullore, duke u bazuar, në dispozitat e Udhëzimit Administrativ, nr.2008/09 të ministrit të MAPL, për transparencën në Komuna, si dhe në dispozitat e Statutit të Komunës së Prizrenit, rregullohet: pjesëmarrja e qytetarëve, si dhe organizatave të tjera nga shoqëria civile në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, në mbledhjet me qytetarët (tubimet publike) të organizuara nga komuna apo nga organet e saj, obligimin dhe mënyrën për njoftim publik për këto mbledhje, si dhe mënyrën dhe konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut (qytetarëve dhe OJQ-të) në vendimmarrje, përfshirë dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

Përkufizimet

Neni 3

Me termet e më poshtme të përdorura në këtë Rregullore nënkuptohet:

1. **“Mbledhjet e Kuvendit të Komunës”** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të ftuara në pajtim me dispozitat e LVL, Statutin e Komunës, apo Rregulloren e Punës të Kuvendit;
2. **“Komitetet”** - nënkupton trupat ndihmëse, të themeluara nga Kuvendi dhe që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësive të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;
3. **“Pjesëmarrja e publikut”** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të tjera joqeveritare apo të interesuarve të tjerë në vendimmarrje;
4. **“Njoftimi publik”** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, në vende të tjera të caktuara për këto qëllime, publikimin e njoftimeve në gazetata e përditshme dhe në internet, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;
5. **“Tubime publike”** - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës - drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike

- lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo shqyrtimin dhe dhënien e propozimeve;
6. **"Petitioni"** - nënkupton kërkesën që i adresohet Komunës nga përgjegjësia e saj;
 7. **"Konsultimi publik i akteve komunale"** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit definitiv të propozimit të aktit;
 8. **"Qasja në dokumentet zyrtare"**- nënkupton shikimin dhe pajisjen me kopje të dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për qasje në dokumente zyrtare.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Neni 4

4.1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

4.2. Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, të paktën 7 ditë para ditës të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme.

4.3. Njoftimi publik bëhet përmes:

4.3.1. shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,

4.3.2. medieve të shkruara dhe elektronike dhe

4.3.3. ueb-faqes së Komunës.

4.4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (a) datën e mbajtjes së mbledhjes, (b) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (c) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (d) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje dhe vendin se ku mund të furnizohen me materialin që është propozuar për shqyrtim në mbledhjen e caktuar.

4.5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura me përjashtim në ato raste kur me ligj apo Statut të Komunës parashihet që mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

4.6. Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të bëhen publike pesëmbëdhjetë (15) ditë pas mbajtjes së mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet.

4.7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Prizrenit.

Mbledhjet e Komiteteve të Përhershme

Neni 5

5.1. Mbledhjet e Komiteteve të përhershme janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik dhe shoqërisë civile.

5.2. Mbledhjet e Komiteteve të përhershme mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e merr kryesuesi i mbledhjes me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

5.3. Zyra për marrëdhënie me publikun njofton mjetet e informimit publik të paktën 2 ditë para mbledhjeve të rregullta, ose 1 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

5.4. Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

Peticioni

Neni 6

6.1. Secili qytetar (qytetarët) dhe personi juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Prizrenit

6.2. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:

- a) rregullimin e qytetit dhe vendbanimeve rurale,
- b) mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së Komunës - qytetit,
- c) urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
- d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
- e) organizimin e referendumit
- ë) zbatimin e vetëkontrollit dhe
- f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

6.3. Një nismë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes kryesuesit të Kuvendit (alternativ - zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës).

6.4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.

6.5. Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 3 000 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 50 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.

6.6. Nëse një fshat, vendbanim apo lagje, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 51% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.

6.7. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

6.8. Kryesuesi i Kuvendit (alternativ, drejtori i Drejtorisë së Administratës), në afat prej 45 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të Komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.

6.9. Vendimin përfundimtar për çështjen e ngritur me peticion e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.

Tubimet me publik

Neni 7

7.1 Komuna së paku dy herë në vit organizon tubime publike periodike me qytetarë.

7.2 Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

7.3 Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.

7.4 Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

7.5 Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin nisma-iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara në pajtim me dispozitat e Statutit të Komunës.

7.6 Njëri prej këtyre tubimeve duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë të vitit.

7.7 Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku dy muajsh.

7.8 Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

7.9 Vendi, data dhe koha kur do të mbahet tubimi publik me qytetarë shpallet në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtes/ën-at e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë më së voni 14 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për marrëdhënie me publikun.

7.10 Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

7.11 Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson kryetari i Komunës, ose personi i autorizuar nga ai.

7.12 Kryetari ka të drejtën që ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ai ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për ato çështje që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë që t'i thërrasë, ose t'i dëgjojë, diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet, si dhe mund ta kufizojë kohën e paraparë për diskutim.

7.13 Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.

7.14 Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

7.15 Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit i shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

Konsultimi publik i akteve komunale

Neni 8

8.1. Projektregulloret e Kuvendit të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Diskutimi publik rreth propozimit do të zgjasë së paku **ditë**. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma të tjera të pjesëmarrjes së publikut.

8.2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:

8.2.a. shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,

8.2.b. medieve të shkruara dhe

8.2.c. faqes së Komunës në internet.

8.3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes, rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje, informatën si dhe ku mund ta marrin materialin rreth çështjes që do të jetë temë e diskutimit publik.

8.4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.

8.5. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.

8.6. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si

dhe ato të marra parasysish. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të propozimit.

Gjuhët për komunikim zyrtar

Neni 9

9.1 Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.

9.2 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në gjuhët që janë në përdorim zyrtar në territorin e Komunës së Prizrenit.

9.3 Aktet normative të Komunës do të shtypen në pajtim me Rregulloren për përdorimin e gjuhëve në territorin e Komunës së Prizrenit.

E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës

Neni 10

10.1 Cilido person fizik, apo juridik, ka të drejtë qasjeje në dokumentet e organeve komunale, duke iu nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Prizrenit.

10.2 Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

10.3 Personat fizikë dhe ata juridikë, nga paragrafi 10.2 të këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe punën e organeve të Administratës komunale.

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

Neni 11

11.1 Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.

11.2 Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.

11.3 Organet kompetente komunale e kanë për obligim që, brenda 7 ditësh nga dita e regjistrimit të kërkesës, të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar, ose të japin përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plot, apo të pjesshëm, si dhe të informojnë kërkuesin për të drejtën e kërkesës për rishqyrtim.

11.4. Pala e pakënaqur, brenda 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, ka të drejtë që nga institucioni të kërkojë rishqyrtimin e vendimit.

11.5. Kërkesa për rishqyrtimin e çështjes duhet të shqyrtohet brenda shtatë ditësh, nga dita e regjistrimit të kërkesës për rishqyrtim.

11.6. Në rast të refuzimit të plot apo të pjesshëm të kërkesës për rishqyrtimin e çështjes , institucioni publik e informon parashtruesin me aktvendim me shkrim.

11.7. Mospërgjigja e institucionit publik brenda afatit të paraparë konsiderohet si përgjigje negative dhe kërkuesi ka të drejtë që të fillojë procedurën para institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, ose gjykatës kompetente

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE - HYRJA NË FUQI

Neni 12

12.1. Me hyrjen e kësaj Rregulloreje në fuqi, pushon të vlejë Plani i Veprimit për Transparencë .

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi Komunal

Nr. 01/011-2570

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit

Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 5, nenit 12 al. 2, pika c, nenit 14, al. 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të propozimit të kryetarit të Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë

V E N D I M

MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

Neni 1

Aprovohet në parim propozimi i kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të objektit me oborr që evidentohet si ngastër kadastrale nr.1615/1, si objekt në sipërfaqe prej 380/m/2, obor në sipërfaqeprej 157/m/2, që gjendet në rrugën Adem Jashari, evidentohet sipas fl. Posedimit nr. 2621, ZK Prizreni si pronë e Komunës, sipas kërkesës së ECPD që është pronë komunale e Komunës së Prizrenit.

Neni 2

Autorizohet Komisioni i Kuvendit të Komunës për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe në këmbim të pronës komunale, konform ligjeve që janë në fuqi, të procedojë me kërkesën e të emëruarit në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Administratës – Sektori për çështje pronëso-ro-juridike.

Neni 4

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Komisioni dhe Drejtoria e Administratës – Sektori për çështje pronëso-ro-juridike.
Ky vendim hynë në fuqi që me ditën e miratimit dhe do të shpallet në web faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-2571

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al.2, pika c , nenit 40 al.2, pika b, nenit 24 al.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 27 al.1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

VENDIM PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2010 DHE 2011 NË VITIN 2012

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet bartja e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2010 dhe gjatë vitit 2011, në shumë prej 1.137.901,69 euro.

Neni 2

Mjetet e bartura do të shpërndahen si vijon: Për programin-Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (kodi 730), nënprogrami Shërbimet e shëndetësisë primare, kodi (73600) dhe në kategorinë e Mallrave dhe të shërbimeve në vlerë prej 29.591,00 euro.

Neni 3

Për programin Arsimi dhe Shkenca (kodi 920), nënprogrami Arsimi i mesëm (kodi 94470), në kategorinë e Pagave dhe meditive në vlerë prej 68.000,00 euro dhe në kategorinë e Mallrave dhe të shërbimeve në vlerë prej 91.439,00 euro.

Neni 4

Për kategorinë ekonomike Investimet kapitale, bartja të bëhet në vlerë prej 948.871,69 euro, për programet dhe nënprogramet e dhëna në tabelarin e projekteve kapitale të vitit 2011, i cili tabelar bashkë me pasqyrën tabelare do të jenë pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Neni 5

Me këtë Vendim do të njoftohet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Kuvendi Komunal

Nr. 01/011- 2338

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr-54/2005, datë 10.5.2005, nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

V E N D I M
PER MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN NË VENDIN E
QUAJTUR ‘‘BOKA’’ TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së për vendin e quajtur ‘‘Boka’’ në qytetin e Prizrenit, në të cilin do të parashihen troje për ndërtim të objekteve individuale, ndërtimi i objekteve me karakter arsimor, objekte me karakter rekreativ-sportiv (poligon gjuetie, stadiumi i qytetit etj), si dhe objekte të tjera për nevojat e KK-Prizren, e cila është hartuar nga ‘‘Byroja projektuese ‘‘DIARKO, shpk nga Prizreni (bartës i hartimit të planit), e që është konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor Nr.2003/14, datë 3.7.2003.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike përmban:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Plani Rregullues Urban për lokacionin **‘‘BOKA’’** të qytetit të Prizrenit, përfshinë lokacionin që ndodhet në ngastrat kadastrale Nr-800/1, 800/2, 801/1, 688/1, 68/2, 694, 689, 697, 760, 756, 757, 759, 532, dhe 3429, e që përfshinë një sipërfaqe prej 78-hektarë e 75-ari,e cila do të inkurajojë, strategjinë zhvillimore të Komunës së Prizrenit për periudhën 5-vjeçare.

Neni 3

Me Planin nga neni 1 të këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t’ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurta për investim.

Neni 4

Ky Vendim, bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1,dhe 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit

Neni 5

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5- (pesë) vjeçare, ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do te shpallet ueb faqen zyrtare t; komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-2339
Më 29 shkurt 2012
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14 dhe të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005, datë 10.5.2005, si dhe nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b)

dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël) – “Parku i Biznesit”

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i Planit Rregullues Urban për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël), - Parku i Biznesit, investitor i së cilës është KK Prizren. Ky plan është hartuar nga Byroja projektuese SH.P.K. “Rafii” nga Prishtina (hartues i Planit Rregullues Urban), në të cilin lokacion parashihet ndërtimi i objekteve industriale, përkatësisht zhvillimi i biznesit në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi të PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- Kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimeve në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- Paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2.

Plani Rregullues Urban për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël), - Parku i Biznesit – përfshinë lokacionin që gjendet në verilindje të qytetit të Prizrenit e që **përfshinë një sipërfaqe prej 80 ha.**

Neni 3.

Me Planin Rregullues Urban për lokacionin Industri e Lehtë (të mesme dhe të vogël) përfshihen këto ngastra kadastrale: 5698; 248/1; 248/2; 249; 250; 251; 252; 253; 254; 255; 256; 260; 261; 262; 266; 267; 268; 269; 1407; 1418; 1451/1; 257; 258/1; 258/2; 259; 260; 265; 1393; 1404; 1405; 1406; 1408/1; 1408/2; 1409; 1411; 1412; 1413; 1414; 1416; 1417; 1419; 1420; 1421; 1422; 1423; 1424; 1425; 1426; 1429/1; 1531; 1435; 1436; 1437; 1438; 1439/1; 1440; 1441; 1442; 1443; 1444; 1445; 1446; 1447; 1448; 1449; 1451/2; 1451/3; 1451/4; 1451/5; 1452, 1461; 1462; 1463; 1464; 1465; 1466; 2185; 3339/1; 3339/2; 3340; 1450; 1453; 1454; 1455 dhe 1456.

Neni 4.

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në përcaktimin e zonës industriale për zhvillimin e biznesit, ekskluzivisht për industrinë e lehtë.

Neni 5.

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1 alineja 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.

Neni 6.

Plani rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 7.

Zbatimi i Planit nga neni 1 i këtij vendimi do të bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës.

Neni 8.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtar”.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-2340

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005, datë 10.5.2005, si dhe nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN - “KUADRATET E 5.6;E 5.9; DHE NJË PJESË E KUADRATIT F 5.2” TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së *“Kuatratit E5.6; E 5.9; dhe një pjesë e Kuadratit F5.2”* të qytetit të Prizrenit, e cila është ofruar si donacion nga “Studio projektuese “CONTROL PRODUCTS, shpk nga Prishtina të cilën e përfaqëson Murat Kuqi, drejtor, (bartës i hartimit të planit), e që është hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit, i cili është hartuar konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr.2003/14, datë 3.7.2003.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban për *““Kuatratit E- 5.6; E- 5.9; dhe një pjesë e Kuadratit F- 5.2”* të qytetit të Prizrenit, përfshihen këto ngastra kadastrale:
6980/1,6981,7053/1,7053/2,7052,7056,7058,6978/1,7057,7059/1,7060/1,7062/1,7066/2, 7066/1,7067,
7069,11059,7070,10994,7083,7082/2,11059/1,7077/3,7082/1,7081,11059/2,7077,7095,7 105,6081,7068,7065,7064,7063,7059/3.

Neni 3

Plani Rregullues Urban përfshinë lokacionin që kufizohet: në perëndim me rrugën “Tirana”, në lindje me rrugën “Wesli Clark”, përkatësisht me kuadratin E 5.1 E.5.7 E.5.8 F.5.1 dhe F.5.5, i cili PRRU do të inkurajojë strategjinë zhvillimore të Komunës së Prizrenit për periudhën 5- vjeçare.

Neni 4

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin

e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurta për investime.

Neni 5

Ky Vendim, bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1,dhe 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit

Neni 6

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5- (pesë) vjeçare, ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do te shpallet ne tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011- 2341

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 16, al.4, pika b të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nenit 12, alineja 1 dhe 2, nenit 15, nenit 17 alineja, 1 pika b dhe nenit 68, al 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, al. , 4 pika (b) dhe nenit 27, alineja 1, si dhe nenit 91 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E ORGANIZIMIT TË SHQYRTIMIT PUBLIK TË
PLANIT RREGULLUES URBAN “INDUSTRI –ZONË E LIRË DHE
TERMINALI” TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet vënia në shqyrtim publik e Planit Rregullues Urban për lokacionin –“Industri - Zonë e lirë dhe Terminali” në Qytetin e Prizrenit, - në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit, e miratuar nga Asambleja Komunale KK Prizren më dt. 16 shtator 2004.

Neni 2

Plani Rregullues Urban për lokacionin - vendin e ashtuquajtur “Industri-Zonë e lire dhe Terminali” përkufizohet, përkatësisht shtrihet ashtu që: në anën perëndimore kufizohet me lokacionin deri ne afërsi të Autostradës Vermicë –Mendarë, ndërsa ne pjesën jugore me rrugën Prizren Vlashnje, gjegjësisht me nyjën e kyçjes në Autostrade, ndërsa ne anën -lindore me lokacionin i cili me PZHU është paraparë ndërtim i lartë, përkatësisht me PRRU-në në anën e majtë të lagjes “Arbana” dhe lokacionin ku është paraparë “Tregti dhe Industri”, e cila do të inkurajojë strategjinë zhvillimore te Komunës së Prizrenit për periudhën 5-vjeçare.

Neni 3

Shqyrtimi publik për Plani Rregullues Urban do të zgjasë së paku 30-(tridhjetë ditë) nga dita miratimit (konform nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005).

Neni 4.

Projekti i Planit Rregullues Urban për vendin e ashtuquajtur – “Industri - Zonë e lirë dhe Terminali” të qytetit të Prizrenit, do të jetë i ekspozuar për shqyrtim publik në objektin e Ekzekutivit të Komunës së Prizrenit (në sallën e madhe), ku do të mbahet debati-(në sallën e madhe për diskutim).

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011- 2342

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 16, al.4, pika b të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nenit 12, alineja 1 dhe 2, nenit 15, nenit 17 alineja, 1 pika b dhe nenit 68, al 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, al. , 4 pika (b), nenit 27, alineja 1, si dhe nenit 91 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E ORGANIZIMIT TË SHQYRTIMIT PUBLIK TË
PROJEKTPLANIT RREGULLUES URBAN “TREGTI DHE INDUSTRI
E VOGEL” TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet vënia në shqyrtim publik e Projektplanit Rregullues Urban “*Tregti dhe Industri e Vogël*” të Qytetit të Prizrenit, e cila është hartuar nga NPT “PRIMA-ENGINEERING nga Prishtina (bartës të hartimit të planit), hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Prizrenit, si dhe konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr.2003/14, datë 3.7.2003.

Neni 2

Projektplanin Rregullues Urban përfshinë lokacionin që kufizohet në anën lindore me rrugën „Tirana,, në anën veriore kufizohet me rrugën „Besim Shala,, në anën jugore me rrugën „Turgut Ozal,, ndërsa në anën-pjesën perëndimore me rrugën „Mbreti Pleurat,- „Aleksandër Xhuvani,- „Kont Urani,, dhe „Beteja e Lumës,, i cili PRRU do të inkurajojë strategjinë zhvillimore të Komunës së Prizrenit për periudhën 5-vjeçare.

Neni 3

Shqyrtimi publik për Projektplanin Rregullues Urban do të zgjasë së paku 30-(tridhjetë dite) nga dita miratimit (konform nenit 5 te Udhëzimit Administrativ nr -54/2005).

Neni 4.

Projekti i Planit Rregullues Urban për ““ *Tregti dhe Industri të Vogël*” “të Qytetit të Prizrenit, do të mbahet (në sallën e madhe për diskutim-kati i III), në objektin e Ekzekutivit të Komunës së Prizrenit (ish Bankkosit), ku dhe do të jetë i ekspozuar për qytetarë-pjesëmarrës në shqyrtim publik.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011- 2344
Më 29 shkurt 2012
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 16, al.4, pika b të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nenit 12, alineja 1 dhe 2, nenit 15, nenit 17, alineja 1 pika b dhe nenit 68, al 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, al. , 4 pika (b) dhe nenit 27, alineja 1, si dhe nenit 91 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E ORGANIZIMIT TË SHQYRTIMIT PUBLIK TË PLANIT
RREGULLUES TË NJË PJESE TË LAGJES „LAKURIQI VERIOR” TË
QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet vënia në shqyrtim publik e Planit Rregullues Urban për lokacionin – një pjesë të Lagjes “*Lakuriqi Verior*” të qytetit të Prizrenit, e cila është hartuara nga Byroja projektuese “RAFii”, shpk nga Rahoveci (bartës i hartimit të planit) në Qytetin e Prizrenit, - në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit e miratuar nga Asambleja Komunale e KK Prizren, dt. 16 shtator 2004.

Neni 2

Plani Rregullues Urban përfshinë lokacionin që kufizohet në, anën *Veriore*-me rrugët „Jakup Ferri,, vazhdon me rrugën „Albrim Fanaj,, „Enver Hadri,, „Martiret e Reqakut,, „Durrësit ,, ,, Filip Shiroka,, dhe deri te lidhja e rrugëve „ Rustë Kabashi,, dhe „Beteja e Kabashit,, , në anën *Perëndimore* kufizohet me Planin Detal Urbanistik ekzistues të lagjes „Ortakoll,, në anën *Jugore*- me Planin Detal Urbanistik ekzistues „Lakuriqi Verior,, ndërsa në anën *Lindore*-kufizohet me rrugën „Ali Ibra,,(afër Kazermës ushtarake të FSK-se), i cili përfshinë sipërfaqen e përgjithshme prej 75 hektarësh.

Neni 3

Shqyrtimi publik për Plani Rregullues Urban do të zgjasë së paku 30-(tridhjetë ditë), nga dita miratimit (konform nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005).

Neni 4.

Projekti i Planit Rregullues Urban për lokacionin e një pjese të Lagjes “*Lakuriqi Verior*” të qytetit të Prizrenit, do të jetë i ekspozuar për shqyrtim publik në objektin e Ekzekutivit të Komunës së Prizrenit (në sallën e madhe), ku do të mbahet debati-(në sallën e madhe për diskutim).

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-2345
Më 29 shkurt 2012
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 16, al.4, pika b të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nenit 12, alineja 1 dhe 2, nenit 15, nenit 17 alineja 1 pika b dhe nenit 68, al 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, al. , 4 pika (b) dhe nenit 27, alineja 1, si dhe nenit 91 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E ORGANIZIMIT TË SHQYRTIMIT PUBLIK TË PLANIT
RREGULLUES URBAN “KUADRATET F-5.5,F-5.6 dhe F.5.7” TË QYTETIT TË
PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet hartimi i Planit Rregullues Urban“*Kuadratet -F-5.5,-F-5.6 dhe -F-5.7*” të qytetit të Prizrenit, i cili ofrohet si donacion nga Byroja projektuese “Diarko,, shpk nga Prizreni (bartës i hartimit të planit), hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit dhe e miratuar nga Asambleja Komunale e KK-Prizren, dt.16.shtator.2004 dhe konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr.2003/14 datë 3.7.2003

Neni 2

Plani Rregullues Urban përfshinë lokacionin që kufizohet - në anën Veriore me rrugën „Rifat Ukimeri,, në anën Jugore-me rrugën e „Jonit,, në anën Perëndimore- me rrugën „J.De Rada,, dhe në anën Lindore- me kuadratin F-5.8.

Neni 3

Shqyrtimi publik për Planin Rregullues Urban do të zgjasë së paku 30-(tridhjetë ditë) nga dita e miratimit (konform nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 54/2005).

Neni 4.

Projekti i Planit Rregullues Urban për „*Kuadratet -F-5.5,-F-5.6 dhe -F-5.7*” të qytetit të Prizrenit, do të jetë i ekspozuar për shqyrtim publik në objektin e Ekzekutivit të

Komunës së Prizrenit (në sallën e madhe), ku do të mbahet debati (në sallën e madhe për diskutim).

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-2346

Më 29 shkurt 2012

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Konform nenit 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr. 2003/14 dhe të nenit 2.2 të Udhëzimit Administrativ, nr.41, datë 4.3.2005, nenit 12, alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17, alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, alineja 4, pika b dhe të nenit 27, alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES URBAN PËR GJATË RRUGËS PRIZREN–LANDOVICË PËRKATËSISHT ANËS SË MAJTË TË RRUGËS DHE NJË PJESË TË ANËS SË DJATHË TË RRUGËS TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim lejohet hartimi i Planit Rregullues Urban (PRRU-së) për lokacionin përgjatë rrugës Prizren –Landovicë, përkatësisht anës së majtë të rrugës dhe një pjesë të anës së djathtë të rrugës në Qytetin e Prizrenit , në të cilën është paraparë ndërtimi i lartë- në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit e miratuar nga Asambleja Komunale KK Prizren më dt. 16. shtator 2004.

Neni 2

Plani Rregullues Urban për lokacionin përgjatë rrugës Prizren – Landovicë, përkatësisht anës së majtë të rrugës dhe një pjesë të anës së djathtë të rrugës, e cila përkufizohet, përkatësisht shtrihet ashtu që: në anën perëndimore kufizohet me lokacionin ku me PZHU është paraparë “Industri-Zonë e lirë dhe Terminali”, ndërsa në

pjesën jugore me lokacionin ku është paraparë “Tregti dhe Industri”, kurse në anën veri-lindore me lagjen “Arbana”

Neni 3

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t’ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim dhe kushte të sigurta të investimit.

Neni 4

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit. Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 5

Pas kompletimit të dokumentacionit me të gjitha elementet e parapara dhe të nevojshme, Projekti i Planit do të vihet në shqyrtim publik, me Vendim të posaçëm.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 7

Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtar”.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-2892
Më 29 shkurt 2012
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu